



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 3 SHTATOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 17:00)

Rendi i ditës:

1. Hapja e Sesionit III të Legjislaturës IX të Kuvendit të Shqipërisë.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 23.07.2018 *(neni 44, pika 2, e Rregullores)*.

3. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, e Rregullores)*.

4. Miratimi i programit 6-javor të punës së Kuvendit për periudhën 3 shtator – 12 tetor 2018 *(neni 26, pikat 5, 6 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

5. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 - 21 shtator 2018 *(neni 27, pikat 3, 4 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Gramoz Ruçi – Seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur.

Në mbështetje të nenit 74, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 42, pika 1, të Rregullores, Kuvendi po hap Sesionin III të punimeve të tij. Paraprakisht u mbledh Konferenca e Kryetarëve, ku u ra dakord që grupet parlamentare të shprehin pikëpamjet dhe këndvështrimet e tyre për zhvillimet politike, por edhe vizionin e tyre për sesionin e ri parlamentar. Me këtë rast, sipas traditës, më lejoni të marr fjalën për të shprehur pikëpamjet e mia për këtë çështje.

Të dashur qytetarë të Shqipërisë,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Sot hapim sesionin e ri parlamentar.

Me këtë rast dëshiroj të ndaj me ju këndvështrimet e mia për arritjet e sesionit që lamë pas dhe për detyrat e Kuvendit përballë sfidave të vendit gjatë sesionit të ri.

Ky sesion së bashku me atë pasardhës do të kenë një mision: kurorëzimin e procesit për çeljen e negociatave në qershor të vitit 2019.

Të gjitha kontributet tona, duke përfshirë luftën politike, duhet t'ia kushtojmë Shqipërisë europiane. Prandaj që në fillim të fjalës sime ftoj të gjitha forcat politike të ndajmë luftën për

betejën e radhës për pushtet nga lufta e përbashkët për integrimin e Shqipërisë në Europë. Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit në çështjet e integritetit evropian do të jetë objektivi ynë i pandryshuar.

Veprimtaria legjislative do të sigurojë përputhshmërinë në përmbytje dhe në cilësi të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Të gjithë duhet të mësojmë nga përvoja e parlamentit kroat, i cili miratoi me konsensus të gjithë kuadrin ligjor të përafrimit dhe jo pak, por 683 ligje.

Arritjet e reformës në drejtësi janë suksesi më i madh i sesionit të kaluar. Shtyllat kryesore të reformës do të vazhdojnë të jenë vetingu, parandalimi, ndëshkimi i korrupsionit në të gjitha nivelet dhe lufta kundër krimit të organizuar. 17 nga 27 projektligjet e paketës së reformës kanë hyrë në fuqi dhe kanë filluar të veprojnë.

Reforma në drejtësi po e pastron sistemin e dekompozuar të drejtësisë dhe po i hap rrugën ndërtimit të një sistemi të pastër. Ky pastrim u përgjigjet etjes dhe urisë së shqiptarëve për drejtësi. 48 seancat e para provuan nevojën jetike të vetingut, ku u konfirmuan 21 gjyqtarë e prokurorë dhe u nxorën jashtë sistemit 27. Fakti që 56 për qind e të shqyrtuarve u shkarkuan tregon se katarsisi i vetingut është ekzistencial për sistemin.

Angazhimi për reformën nuk ka sjellë gjithmonë produktin që prisnim.

Këshilli për Legjislacionin nuk e përmbushi detyrën për shqyrtimin e ndryshimeve për zbatimin e pesë vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Mosmiratimi i ligjit për Magjistraturën tregoi se dakordësia për nevojën e pastrimit nuk u mbështet nga konsensusi për ndërtimin e arkitekturës së sistemit, por kemi rastin ta korrigjojmë dhe ta plotësojmë atë në sesionin e ri parlamentar. Cilatdo qofshin kostot e reformës, jemi “të dënuar” të rindërtojmë degën gjyqësore, shtyllën e demokracisë, e cila po sfidonte të drejtën dhe po dëmtonte interesin publik.

Reforma nuk pretendon të drejtën hyjnore, por drejtësi të pakushtëzuar nga paraja e pushteti; drejtësi të kushtëzuar nga qytetarët, Kushtetuta dhe interesat e vendit.

Nuk është në dorë as të Kuvendit, as të qeverisë të krijojnë apo t’u japin të drejta

qytetarëve. Të drejtat nuk burojnë nga foltoret dhe as nga fuqia e bujaria jonë, por nga liria njerëzore. Qëllimi sublim i reformës është garantimi i ushtrimit të të drejtave të qytetarëve. Përgatitja prioritare e ligjeve për zbatimin e reformës në drejtësi do të vazhdojë të jetë objektivi e sfida kryesore e sesionit të ri parlamentar. Këtu kam parasysh miratimin e akteve të reformës në proces; konsensusin për miratimin e ligjeve me shumicë të cilësuar; miratimin e ndryshimeve ligjore, në reflektim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për reformën në drejtësi, si projektligji “Për statusin e gjyqtarëve” dhe projektvendimi “Për ngritjen e komisionit të pavarur për zbatimin e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i depozituar në maj të vitit 2018; ndryshimet e tjera për përmirësimin e kornizës ligjore të sistemit; ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit për të reflektuar ndryshimet kushtetuese dhe, së fundi, finalizimin e ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë brenda këtij sesioni.

Funksioni ligjibërës i Kuvendit gjatë sesionit të kaluar u fuqizua dukshëm.

U miratuan 55 ligje, nga të cilat me shumicë të cilësuar (absolute) 26, me shumicë të thjeshtë 29 dhe me konsensus 8 ligje. Po nënvizoj dy arritje të procesit ligjibërës:

Së pari, rritjen e numrit të ligjeve të miratuara me konsensus. Prej shtatorit 2017 janë miratuar me konsensus 17 ligje ose mbi një e pesta e ligjeve të votuara.

Së dyti, një e pesta e 101 akteve ligjore, të depozituara që në shtator të vitit 2017, kanë ardhur nga deputetët, duke mundur një rol më proaktiv të Kuvendit në ligjibërje.

Reforma zgjedhore do të jetë angazhimi prioritar i këtij sesioni. Ajo do t’u paraprijë zgjedhjeve të ardhshme vendore. Ky do të jetë objektivi ynë parësor për këtë sesion. Konsolidimi i sinergjisë legjitimitet-integritet-moralitet i legjislativit mbetet gjithashtu prioriteti ynë.

Kodi i Sjelljes në Kuvend, i miratuar në prill të vitit 2018, po mbështetet nga ndryshimet e Rregullores dhe nga Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend, i cili po konsultohet edhe me OSBE-në.

Opozita ka pasur dhe do të ketë të gjitha kushtet për ta ushtruar plotësisht pushtetin legjislativ për të kontrolluar shumicën

qeverisë. Gjatë 25 seancave plenare të sesionit të kaluar, opozita zhvilloi 54 për qind të 673 diskutimeve, kërkoi 3 nga 4 interpelancat urgjente dhe iu plotësuan 91 nga 111 kërkesat për informacion nga ekzekutivi. Edhe gjatë sesionit të ri do të ketë më shumë akses.

Gjithashtu, do të vazhdojmë të ngushtojmë asimetritë midis funksionit ligjvënës e kontrollues të Kuvendit. Gjatë sesionit që kaloi kontrolli parlamentar u fuqizua nga përmirësimi i mekanizmit të monitorimit Kuvend-qeveri-institucione të pavarura, i cili po jep rezultatet e para.

Së shpejti do të ndërtohet platforma *online* e rekomandimeve, duke e bërë këtë instrument efikas dhe konkret.

Duke ndaluar shkeljen e mëtejshme të nenit 103 të Rregullores, vendosëm standardin thelbësor për kontrollin parlamentar, i cili mungonte prej vitesh. 19 drejtues të institucioneve të pavarura paraqitën raportin vjetor në seancë plenare dhe Kuvendi miratoi 19 rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së tyre.

Gjatë këtij sesi do të organizojmë tryezën e dytë “Mekanizmi ndërinstitucional me qeverinë dhe institucionet e pavarura”.

Kalendari i Kuvendit ka qenë dhe do të jetë i hapur për axhendën e ekzekutivit në përputhje me prioritetet legjislative dhe interesat jetike të Republikës.

Kuvendi nuk kontrollohet, por kontrollon qeverinë. Prandaj, dëshiroj të bëj të qartë se asnjë ministri dhe institucion nuk do të mbetet jashtë monitorimit parlamentar.

Kuvendi do të vazhdojë të ngushtojë deficitin demokratik nëpërmjet rritjes së transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve e të shoqërisë civile në procesin legjislativ. 19 seanca dëgjimore, me pjesëmarrjen e 294 grupeve të interesit dhe shoqërisë civile, qindra rekomandime të paraqitura dhe 555 të miratuara, janë dëshmi e këtij kontributi.

Kuvendi, komisionet dhe ekspertët tanë po ndjekin me vëmendje sensibilitetet qytetare, publike e mediatike për ngjarjet e zhvillimet në vend, disa prej të cilave mund të kërkojnë ashpërsim të dispozitave ligjore në fuqi.

Garantoj të gjithë shqiptarët se ndjeshmëritë e tyre legjitime do të shqyrtohen me kujdes nga ligjvënësit, do të përkthehen në

dispozita ligjore në çdo rast që do të gjykohej e nevojshme për interesin publik.

Parimi jetësor i demokracisë është se askush nuk mund të qeverisë pa dëgjuar zgjedhësit, pa konsensusin dhe pa bashkëpunimin e tyre.

Dëgjimi i qytetarëve përmirëson performancën dhe rrit fuqinë e besimit publik të Kuvendit.

Ju faleminderit dhe punë të mbarë në këtë sesion të ri parlamentar!

Atëherë, siç ju thashë, në Konferencën e Kryetarëve kemi rënë dakord që në hapjen e sesionit të ri parlamentar të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare të merrnin fjalën për të paraqitur para Kuvendit dhe publikut vizionin e tyre. Siç mund ta shikoni, grupet parlamentare të opozitës, pa asnjë njoftim, përkundrazi, edhe pse kishin shprehur angazhimin për të kërkuar fjalën, nuk janë në këtë seancë të hapjes së sesionit të ri parlamentar. I pranishëm në hapjen e këtij sesi është vetëm grupi parlamentar i maxhorancës.

Zoti Balla, keni fjalën!

Taulant Balla – Faleminderit, zoti Kryetar!

Është e vërtetë që në Konferencën e Kryetarëve kemi rënë dakord që në hapje të këtij sesi të merrnin fjalën drejtuesit e grupeve parlamentare për të diskutuar dhe për të kontribuar të gjithë së bashku në një fillim të mbarë të punimeve të sesionit të tretë të kësaj legjislature. Sikurse jemi informuar nga mediet, dy grupet e opozitës janë në Shkodër për të zhvilluar një takim mes tyre për çështjen e rendit publik. Do të doja t'u bëja thirrje medieve që ta kenë vëmendjen te shifrat që do të jap pak më poshtë, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e rendit publik në Shkodër dhe krahasimisht se si ka qenë ajo në vitet e shkuara. Shifrat janë të tilla që rendi publik prej vitesh ka qenë problematik në atë pjesë të territorit. Për sa u përket vrasjeve, të cilave u referohet Partia Demokratike, në vitin 2010, kur ministër i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë ishte kryetari aktual i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ato arritën në nivelin më të lartë, 18 vrasje vetëm në qarkun Shkodër, krahasuar me 8 vrasje gjatë periudhës janar-gusht 2018.

Edhe gjatë vitit 2012 ka qenë po ai numër i lartë, 18, dhe mesatarja ka qenë 15 vrasje në mandatin e dytë dhe të fundit të Partisë

Demokratike, krahasuar me numrin 9, mesatarja gjatë vitit tonë të parë të qeverisjes. Sigurisht, ne jemi shumë të shqetësuar për çdo jetë të humbur nga krimi dhe vrasjet e fundit në Shkodër duhen zbuluar dhe ndëshkuar sa më parë.

Zoti Ministër i Brendshëm, ne kemi besim te puna juaj dhe e policisë dhe presim reagim sa më të shpejtë e sa më të fortë, një përgjigje kuptimplotë, ndaj kujt do që ka gisht në shqetësimin e qytetarëve shkodranë. Dua të ripërsëris thirrjen time drejtuar medieve që t'i verifikojnë këto të dhëna kuptimplota dhe të mos i ushqejnë aspak njerëzit e thjeshtë me helmin e çorbës së SHQUP-it.

Ne, Partia Socialiste e Shqipërisë, vijmë në këtë fillim sesioni parlamentar pasi përgjatë muajve maj, qershor dhe korrik kemi zhvilluar një proces komunikimi intensiv me njerëzit në çdo cep të territorit. Sot nga kjo foltore, si kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, dua t'i falënderoj personalisht të gjithë ata që morën pjesë direkt ose përmes rrjeteve sociale, në llogaridhënien publike të qeverisë "Puna për Shqipërinë që duam". Ishte një proces i hapur, pa dallime partiake, ku të shumtë ishin edhe ata që nuk na besuan më 25 qershor 2017, por që përsëri duan dhe insistojnë që zëri t'u dëgjohet dhe që i zgjedhuri prej tyre t'u dalë për zot halleve. Zëri i tyre jo vetëm u dëgjua, por është detyra jonë për ta vendosur në rrugën e zgjidhjes. Ne nuk kemi një shklop magjik që ta ndryshojmë Shqipërinë brenda një dite, madje as brenda një mandati, por ne jemi të vendosur ta kemi vëmendjen vetëm te njerëzit. Jemi të përkushtuar për t'u marrë me hallet dhe problemet e njerëzve dhe vëmendja jonë janë vetëm ata.

Duke reflektuar, në fakt, edhe sipas asaj që tha Kryetari i Kuvendit, mbi të shkuarën e afërt të punimeve të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë sesionit të fundit që mbyllëm në fund të korrikut, kemi konsumuar pa fund politikë shterpë për luftëra pa kuptim interesash partiake, duke harruar dhe duke lënë jashtë vëmendjes njerëzit. Nga kjo sallë njerëzit presin prej nesh tjetër gjë.

Është e vërtetë që kjo sallë është aula e debatit politik, por detyra jonë kryesore është që debati të fokusohet te hallet dhe problemet reale të njerëzve, jo te shterpësia e një partie politike apo e një opozite. Detyra jonë është, si në çdo parlament të vendeve anëtare të Bashkimit

European, të diskutojmë mbi alternativat dhe projektet, mbi çdo projekt apo propozim tonin, të shumicës dhe të qeverisë. Pakica mund të ketë idetë apo alternativat e saj. Ne vijmë këtu me një propozim konkret, me një ligj, me një projektvendim, me një politikë të caktuar, kurse opozita ka të drejtë të vijë me propozimet apo idetë e saj. Për ne sot, në këtë fillim të vitit të ri shkollor, risia më e rëndësishme janë librat falas për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e katërt, pra për 190 mijë nxënës në Republikën e Shqipërisë. Ne e bëmë këtë hap në këtë vit të ri shkollor, sepse deri më sot nuk kishim mundësi dhe sot është mundësia për të bërë këtë falë reformave dhe progresit, që na kanë dhënë disa hapësira të reja për të bërë më shumë investime në disa drejtime, ku kemi dashur të bëjmë më shumë dhe më parë, por më parë na është dashur të shlyejmë borxhe të rënda dhe të çelim kantieret e reformave.

Vitin e ardhshëm në këtë program do të përfshihet edhe klasa e pestë dhe ambicia jonë është që deri në fund të këtij mandati i gjithë arsimit i detyrueshëm, pra deri në klasën e nëntë, të mbulohet me libra shkollor falas. Ishte kjo një prej qindra kërkesave që na doli gjatë dëgjësive të llogaridhënies publike të qeverisë. Kjo po që është temë, të cilën mezi presim ta diskutojmë edhe me opozitën, sepse këtë temë duan të dëgjojnë njerëzit në foltoren e Kuvendit të Shqipërisë.

Zonja dhe zotërinj,

Sot Kuvendi i Shqipërisë fillon sesionin e tij të tretë të kësaj legjislature, deri në fund të të cilit Presidenti i Republikës do të dekretojë edhe datën e zgjedhjeve vendore të vitit 2019. Pra, detyra jonë kryesore e përbashkët, edhe e kësaj pjesë të sallës, e cila sot është bosh, është që gjatë këtij sesioni dhe deri në fund të dhjetorit të kemi finalizuar tërësisht reformën zgjedhore. Ne jemi të gatshëm të diskutojmë dhe të miratojmë së bashku me opozitën mundësinë e pilotimit të votimit dhe të numërimit elektronik *online*, kërkesë e cila ka qenë parakusht i kahershëm i Partisë Demokratike për reformën zgjedhore. Ndërkohë, duhet të përmbyllem brenda afatit dhe standardeve më të mira, të cilat janë 6 muaj para zgjedhjeve, adresimin e plotë të rekomandimeve të raportit të OSBE /ODIHR-it. Nuk ua kam thënë sot kolegut Spaho dhe as kolegëve të tjerë të opozitës se procesi i reformës zgjedhore duhet

përmbyllur brenda mesit të tetorit, për t'i lënë kohë edhe Komisionit të Venecias që të shprehet, që në fillim të dhjetorit ta miratojmë së bashku paketën e plotë.

Prandaj, i dashur Lulzim, që mezi prisnim të të kishim sot këtu në sallë bashkë me kolegët e tu, mos e humbisni më kohën kot me thirrje dhe përbetime revolucionesh, që nuk kanë për të ndodhur kurrë. Mos humbisni kohë as me shtrimin e tapetit të alibisë për humbjen e radhës. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me ju plotësisht për t'i dhënë Shqipërisë një Kod të ri Zgjedhor sipas standardeve më të mira zgjedhore, por ata duhet ta fiksojnë mirë në mendje, edhe atje ku janë sot, që të mos kërkojnë që të heqim vëmendjen nga njerëzit dhe të fokusohemi tek akuzat dhe shpifjet pafund tri herë në ditë. Vëmendja jonë është vetëm te njerëzit e thjeshtë dhe të zakonshëm të këtij vendi. Ne e dimë që rezultatin zgjedhor apo fitoren nuk e vendos as elektronika, as Kodi dhe asgjë tjetër, përveçse vullneti i njerëzve.

Për hir të standardeve më të mira, me eksperiencën dhe me punën e mirë të bërë nën drejtimin e dy bashkëkryetarëve të Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe me punën shumë të mirë të të gjithë anëtarëve të këtij komisioni, ejani dhe ta mbyllim këtë punë deri në mes të tetorit, kur është edhe përfundimi i programit që do të miratojmë sot, por është edhe përfundimi i mandatit të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Të jesh në opozitë, do të thotë të bësh pjesë në një institucion serioz. Nuk mund të jetë opozita e Shqipërisë europiane, kjo opozitë që shpik tri kauza në ditë, të bazuara në shpifje dhe trillime, të cilat i merr nga grupe delenxhinjsh e hajdutësh të ish-administratës së tyre. Është pikërisht ky model opozitarizmi që prodhon kauza të rastësishme, siç janë kauzat e shpikura nga kjo opozitë ditë për ditë.

Zonja dhe zotërinj, në fillim të korrikut komisioneri për zgjerim, zoti Hahn së bashku me qeverinë shqiptare hodhën hapin e parë në procesin *screening*, që është edhe pjesa më e rëndësishme e procesit parapërgatitor të negociatave me Bashkimin Europian. Ky është një proces teknik, i cili do të bëjnë inventarin e ligjeve dhe sjelljen institucionale në përputhje me normat e *acquis communautaire*, ose normat e Bashkimit Europian. Në këtë proces ne i kemi besuar opozitës dy prej institucioneve më të

rëndësishme, madje për Kuvendin janë dy institucionet e vetme që prekin Kuvendin në procesin e integritetit europian: Këshillin për Integrimin Europian dhe Komisionin për Integrimin Europian. Këto dy institucione drejtohen nga opozita, prandaj është momenti që opozita t'i kthehet punës, sepse mjaft pushoi, dhe të punojmë së bashku këtu në Kuvendin e Shqipërisë dhe përmes çdo institucioni tjetër për të bërë detyrën për të cilën na ka sjellë populli në këtë sallë.

Punë të mbarë Kuvendit të Shqipërisë!
Vëmendja jonë është te njerëzit! Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Balla!

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Lidhur me procesverbalin, a ka vërejtje?
Nuk ka. Kush është dakord?

Miratohet procesverbali.

Ju njoftoj se janë propozuar 7 projektligje nga Këshilli i Ministrave dhe një projektligj nga deputeti Alket Hyseni.

Njëri nga projektligjet e Këshillit të Ministrave është kërkuar të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar. Votimi do të bëhet së bashku me çështjet e tjera të rendit të ditës.

Nga Presidenti i Republikës janë depozituar 2 dekrete për rishqyrtim ligji. Materialet do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Titujt i keni të gjithë përpara te njoftimet që ju kemi bërë.

Për sa i përket draftprogramit të punës së Kuvendit dhe draftkalendarin 3 javor për periudhën në vijim, ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, por nuk pati konsensus.

Në mbështetje të nenit 26, pika 6, dhe nenit 27, pika 4, të Rregullores do t'i hedhim në votim.

Kush është dakord me programin? Kundër? Abstenim?

Miratohet programi.

Kush është dakord me kalendarin?

Miratohet edhe kalendarin.

Programin e punës dhe kalendarin do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Projektvendim për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëshmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist," të ndryshuar".

Ky projektvendim, sipas nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 28 të Rregullores, shprehet një folës pro dhe një kundër.

A ka ndonjë që do të marrë fjalën për pro ose kundër? Nuk ka.

Projektvendimi u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Komisioni përgjegjës do të jetë Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave.

Hapet votimi për prezencën.

Baraj dhe Ndreu nuk janë?

Mbyllet votimi.

Janë të pranishëm 74 deputetë.

Hapet votimi me elektronikë për projektvendimin për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmtshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar.””

Vazhdon votimi.

Mbyllet votimi.

Miratohet me 74 vota pro projektvendimi për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmtshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar.””

Pika e fundit e rendit të ditës së sotme është diskutimi për çështje jashtë rendit të ditës.

Ka kërkuar fjalën ministri, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkova të flas në këtë seancë për një çështje shumë të ndjeshme, me një debat të hapur publik, lidhur me situatën e rendit dhe të sigurisë këta muajt e fundit në shkallë vendi, posaçërisht në disa qarqe të vendit dhe, në mënyrë të veçantë, në qarkun e Shkodrës, kjo lidhur edhe me ngjarjet e fundit të ndodhura në këtë qark, me disa vrasje gjatë muajit qershor, korrik, gusht dhe tani në shtator. Natyrisht, ajo çfarë është duke bërë opozita nuk është gjë tjetër veçse një sulm agresiv i qëllimshëm, për të krijuar një perceptim të gabuar rreth rendit dhe sigurisë në vend dhe, pa dyshim, për të nxirë imazhin e vendit dhe të policisë. Nuk dua t’i hyj fare diskutimit se cili është konteksti i vrasjeve që kanë ndodhur këta muaj në Shkodër, as se cila është natyra e disa prej viktimave të përfshira në

këto ngjarje, apo sa dhe si këta të fundit kanë qenë të përfshirë në vrasje të mëparshme si autorë. Kjo nuk është detyra ime sot. Kjo është përgjegjësi e hetimit, që është duke u zhvilluar me shumë intensitet, me një përgjegjësi të veçantë së bashku me Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe Prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër. Natyrisht, për ne çdo rast vrasjeje përbën një ngjarje të rëndë, që cenon qetësinë, rendin dhe sigurinë e qytetarëve, sepse janë jetë njerëzish. Ne jemi të vendosur t’u shkojmë deri në fund këtyre ngjarjeve dhe shpresoj se shumë shpejt do të përgjigjen përpara ligjit si autorët, ekzekutorët e tyre, ashtu edhe nxitësit e këtyre ngjarjeve të rënda penale. Kjo për sa i përket përgjegjësisë sonë shtetërore dhe përgjegjësisë përballë qytetarëve të Shkodrës. Për sa i përket opozitës, ajo ka zgjedhur një kauzë të gabuar. Para së gjithash, do të duhej të jepte llogari para qytetarëve të Shkodrës për sigurinë dhe rendin në periudhën kur ka drejtuar vendin.

Kryetari i grupit parlamentar përmendi disa shifra, por kam përgjegjësinë të bëj publike disa shifra konkrete në shkallë vendi dhe posaçërisht për disa nga këto qarqe. Vrasjet me dashje në Republikën e Shqipërisë, në mandatin e parë të Partisë Demokratike, kanë qenë rreth 230 ose me një mesatare prej rreth 58 vrasjesh në vit; në mandatin e dytë të tyre, me një mesatare prej 72 vrasjesh në vit.

Në mandatin tonë të parë 2013-2017 mesatarja e vrasjeve në vit ka qenë 43 dhe për këtë vit deri në kohën që jam duke folur kanë qenë 24 të tilla. Ky është nga pikëpamja statistikore numri i vrasjeve në shkallë republike dhe le t’i krahasojë kush të dëshirojë, 58 ka qenë mesatarja në mandatin e tyre të parë, 72 në mandatin e dytë, 43 në mandatin tonë të parë dhe 24 këtë vit që jemi duke folur. Në Shkodër, në mandatin e tyre të parë mesatarja ka qenë 12 vrasje në vit, në mandatin e dytë 15 vrasje në vit. Në mandatin tonë të parë 9 vrasje dhe për këtë vit janë 8 vrasje, nga të cilat janë zbuluar 4 deri tani dhe janë në proces hetimi 4 vrasjet e tjera. Nëse do t’i merrnim sipas viteve, në vitin 2010 në Tiranë kanë ndodhur 25 vrasje, në vitin 2013, 31 vrasje, në vitin 2017, 9 vrasje, në vitin 2018, 6 vrasje. Në Durrës, në vitin 2010, 15 të tilla, në vitin 2013, 13 vrasje, në vitin 2017, 6 vrasje dhe në vitin 2018, 4 vrasje. Në Elbasan, në vitin 2010, 11 të tilla, në vitin 2013, 4 vrasje, në vitet

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 3 SHTATOR 2018

2017 dhe 2018 respektivisht nga 1 vrasje. Në Shkodër, siç edhe jua thashë, 18, 11, 6 dhe 8 vrasje, pa hyrë te plagosjet e rënda. Në dy mandatet e tyre të mëparshme ka pasur 13 plagosje të rënda në Shkodër, kurse shifrat tona kanë qenë 2 në vitin 2016, 6 në vitin 2017 dhe 1 në vitin 2018, pa hyrë te veprat e tjera penale të rënda, siç janë vjedhjet me armë e të tjera. Pra, statistikisht nuk ka shifra që mund të krahasohen. Po jua them këtu me përgjegjësi të madhe publike, jo vetëm për këto lloj veprash penale, por për të gjithë treguesit statistikorë të krimit të këtij viti krahasimisht me të gjitha vitet kur ka qeverisur Partia Demokratike. Kjo nuk është çështje statistikash, pasi edhe një ngjarje e vetme është një përgjegjësi dhe unë jam plotësisht i përgjegjshëm, i vetëdijshëm, i ndërgjegjshëm për këtë përgjegjësi. Kjo është arsyeja pse ne jemi përfshirë në një luftë intensive me grupet kriminale. Në këta pak muaj kemi bërë një skanim dhe një profil të plotë të grupeve kriminale, që nuk u krijuan as dje, as pardje, por që e kanë zanafillën vite më parë me aktivitet intensiv.

Deri tani kemi goditur një pjesë të konsiderueshme të grupeve kriminale dhe gjatë muajve shtator-tetor, në sajë të provave të mbledhura, si dhe pas punës intensive që kemi bërë gjatë kësaj periudhe, jemi të bindur se do të goditen një pjesë e mirë e këtyre grupeve kriminale.

Natyrisht, ne do ta vijojmë me përgjegjësi dhe përkushtim luftën pa kompromis ndaj këtyre grupeve kriminale. Operacioni “Forca e ligjit” është duke vepruar dhe do të vazhdojë të shënojë rezultate konkrete në një luftë pa kompromis me të gjitha grupet kriminale të çfarëdolloji qofshin dhe kudo qofshin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Këtu mbylлим seancën e ditës së sotme.

Seanca tjetër është ditën e enjte në orën 10:00.

Faleminderit dhe suksese!

(Seanca u mbyll në orën 17:45)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**